



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500544/7

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Rekomandime për marrje masash të nevojshme në mbrojtje të shëndetit, jetës, mjedisit si dhe pasurisë të banorëve të Fshatit Marinëz, Fier,*

Drejtuar : **Ilir Beqja**
Ministër i Shëndetësisë

Lefter Koka
Ministër i Mjedisit

Edmond Panariti
Ministër i Bujqësisë, Zvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

Damian Gjikhuri
Ministër i Energjisë dhe Industrisë

TIRANE

Të nderuar zotërinj Ministra!

Sikurse dihet, ngjarja e ndodhur më datë 01.04.2015, në Vendburimin e Naftës, Marinëzë, gjatë shpimit të Pusit të Naftës nr.5761 prej operatorit privat, ka shkatuar shqetësime si dhe cënim të shëndetit dhe pasurisë së banorëve të Fshatit Marinëz, Fier. Kjo ngjarje e ndodhur ka marrë vëmendjen maksimale jo vetëm prej organeve të ndryshme shtetëror por edhe të Institucionit të Avokatit të Popullit. Në mbrojtje të së drejtës së jetës, pasurisë së cilitdo personi të ndodhur në këtë zonë, Institucioni i Avokatit të Popullit më datë 01.04.2015, ka bërë të mundur dërgimin e grupit të punës për evidentimin e veprimtarisë së organeve të ndryshme shtetërore në mbrojtje të të drejtave të garantuara me ligj cilitdo individ.

Në mënyrë vijues është bërë e mundur administrimi i gjithë të dhënave të marra pranë objektit të vendngjarjes, banorëve të zonës, organeve të ndryshme të pushtetit vendor dhe qendror, të cilat kanë prodhuar informacion dinamik rreth situatës shëndetësore të banorëve të Fshatit Marinëz, Fier, ndotjes së mjedisit në këtë zonë si dhe dëmtimit të pasurive.

Institucioni i Avokatit të Popullit pavarësisht verifikimeve, monitorimeve në vend dhe informacioneve të marra nga institucionet shtetërore ka marrë dhe ekspertizë nga ekspertë të kësaj fushe për të nxjerrë konkluzione të qarta dhe të specializuara.

- a) Të dhënat e marra prej organeve të caktuara shtetërore, si Qendra Shëndetësore Marinëz, Drejtoria Rajonale e Shëndetit, Fier, apo Insituti i Shëndetit Publik, flasin për përkeqësim të situatës së ndotjes të mjedisit dhe cënim të shëndetit të banorëve në këtë zonë. **Statistikat e dhëna prej organeve në fjalë, si dhe shpjegimet e dhëna prej personelit mjeksor, tregojnë për ekzistencën e ndotjes së mjedisit tej normave të lejuara si dhe cënim të shëndetit të banorëve.** Vetëm gjatë periudhës prej 15 ditëve nga ngjarja e ndodhur më datë 01.04.2015, në Qendrën Shëndetësore, Marinëz, apo Spitalin e Qytetit të Fierit, janë paraqitur afro 250 persona (më shumë se 10% e banorëve të Fshatit Marinëz) me simptoma të cilat vijnë dhe si pasojë e ndotjes së mjedisit, ku ata jetojnë, nga gazrat e emetuar në atmosferë gjatë fontanimit apo veprimtaria e përditëshme e nxjerrës së naftës në këtë vendburim.
- b) Pas shpërthimit të pusit të naftës në Marinëzë, edhe pse ka pasur shkak, nuk pati evakuime të banorëve të organizuara nga institucionet shtetërore përkatëse. Largimi i pjesëshëm i banorëve u bë nga vetë subjekti i cili zhvillon veprimtarinë naftënxjerrëse, veçanrisht nga banesat që ishin më afër zonës së shpërthimit dhe që u dëmtuan më shumë nga ky incident.
- c) Në situatën e krijuar, institucionet shëndetësore rajonale dhe qendrore, edhe pse kanë organizuar analizat e nivelit toksik të mjedisit, veçanrisht të ajrit, të ujit të pijshëm të Marinëzës si dhe të disa mostrave toke, për aq sa informacion kemi, nuk kanë analizuar prodhimet bujqësore e blegtorale në zonën e prekur në periudhën e parë të emergjencës. Ato janë duke u kryer tani, nga institucionet e bujqësisë dhe ushqimit, pas shfaqjes së ankesave dhe shqetësimeve të banorëve.
- d) Gjithashtu, në dijenin tonë nuk u organizua ndonjë punkt laboratorik fushor për analiza (eksprese) emergjente dhe në dinamikë për ajrin, ujrat, tokën dhe prodhimet bujqësore e blegtorale, sidomos për elementët specifik me toksicitet të lartë që shoqërojnë zakonisht gazet, ujrat dhe naftën e puseve të naftës. Prania e të cilave në nivele toksike mund të kishte shkaktuar një tragjedi të vërtetë qysh në momentet e para të shpërthimeve (fontanës) të pusit nr. 5761 dhe të grifoneve.
- e) Referuar analizave laboratorike të Drejtorisë Rajonale Shëndetësore, Fier, dhe të Insitutit të Shëndetit Publik të datave 10 dhe 16 Prill 2015, pas shpërthimit të pusit të naftës në Marinëzë, ka rezultuar prania e elementëve toksikë në ajër, në ujë dhe në tokë mbi normat e lejuara maksimale. **Kështu, prania e substancës toksike të gazit sulfhidrik (H₂S) në ajër ka qënë në disa mostra rreth 20 herë mbi normën e lejuar, ndërsa e gazit metan (CH₄) rreth 3-5 herë mbi normën e lejuar.** Në raste aksidentesh të tilla në zonat e banuara, zakonisht merren masa emergjente me monitorime ekspres dhe të vazhdueshëm të nivelit toksik të ajrit, duke përdorur jo vetëm aparate matëse laboratorike por edhe monitorë portativë

dhe maska respiratore specifike, gjë që në rastin konkret nuk ndodhi, ndofta për mungesa organizative dhe instrumenta mbrojtës-individualë dhe monitorues.

- f) Në një raport të Insitutit të Shëndetit Publik, mbi vlerësimin e situatës mjedisore dhe shëndetësore në Marinzë, i datës 29.04.2015, **vihen në dukje një sërë shfaqjesh të theksuara simptomatologjike, karakteristike e ekspozimit të banorëve të Marinzës ndaj ndotësve të ajrit, të emetuar nga komponimet e hidrokarbureve dhe gazrat shoqëruese toksike.** Këto simptoma lidhen me probleme pulmonare(astma bronchiale,pneumoni dhe bronkite), me lëkurën (forma aler- gjike, prurite, dermatite, ekzema), me djegie dhe skuqie të syve, shqetësime më të rralla për konfuzion mendor, marrje mëndësh, tremorit(dridhjes), përgjumje, dhimbje koke, dhimbje barku, këputje trupore, shqetësime të theksuara nga lëkundjet sizmike të shpeshta. Në këtë raport jepen rezultatet e analizës së fenolit në urinën e 8 banorëve të Marinzës, përmbajtja e të cilit ka qënë rreth dyfishin e normës mjekësore.
- g) **Analizat e përsëritura të ajrit evidentojnë një rënie në krahasim me vlerat e ditëve të para pas incidentit. Në raportin e mësipërm rekomandohet ndjekja e shërbimit shëndetësor të specializuar për banorët e Marinzës, një depistim i popullatës së zonës dhe vazhdimi i monitorimit të zonës lidhur me ndotjen mjedisore dhe risqet shëndetësore të derivuara prej tyre.** Duhet theksuar se megjithë evidentimin e nivelit të lartë toksik të ajrit(sic u përmënd më sipër), banorët nuk janë larguan nga banesat por vazhduan jetën e tyre në mjedis toksik, gjë që nuk duhej lejuar nga organet shtetërore përkatëse. Pati largime sikurse u shprehëm më lart vetëm të disa familjeve.
- h) **Kjo neglizhencë nuk përjashton mundësinë e dëmtimeve shëndetësore anësore tek banorët e ekspozuar për kohë të gjatë në këtë mjedis toksik, veçanërisht tek fëmijët, personat në moshë të tretë, dhe në personat me probleme apo episode patologjike shëndetësore, të cilat evidentohej edhe në raportin e më sipërm të ISHP.** Përmirësimi i mjedisit, e për rrjedhojë mbrojtja e shëndetit, jetës, pasurisë së individëve, përsa i përket ndotjes së tij nga elementët e emetuar në zonën e Vendburimit Patos-Marinëz, është i mundshëm të kryhet me rastin e respektimit dhe ushtrimit të detyrimeve që ka cilido subjekt shtetëror apo privat që ushtron veprimtari naftënxjerrëse, në përputhje me rregullat e sigurimit teknik të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo situatë jo normale në zonën e Marinzës, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, do të mund të shmanget e të mospërsëritet në rast dhe të respektimit të rekomandimit si më poshtë përcaktuar per sejcilën ministri.

Me qëllim sigurimin e jetës, shëndeti dhe pronës së banorëve të zonës, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenit 21/b, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje*

masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDON

Marrjen e masave për evakuimin e përkohshëm të banorëve nga zona me rrezikshmëri të lartë intoksikimi, deri në normalizimin e situatës së ndotjes në këtë zonë.

Ministrisë së Mjedisit dhe Asaj të Bujqësisë, Zvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave;

Mbajtjen në kontroll të vazhdueshëm dhe sistematik të nivelit të ndotjes në Vëndburimin e Marinzës, në shkallë rajonale e më gjerë, nivelit të pastërtisë ekologjike të ajrit, ujrave, tokave, të kulturave bujqësore dhe produkteve blegtorale, duke zhvilluar në mënyrë periodike (ditore apo javore) analiza mikrobiologjike, fiziko-kimike dhe toksikologjike të detajuara, karakteristike për të gjitha substancat toksike në mjedisin naftëmbajtës të Marinzës, me qëllim garantimin e shëndetit, jetës dhe pasurisë së banorëve të zonës së Marinzës, Fier.

Ministrisë së Shëndetësisë dhe Asaj të Mjedisit;

Kryerjen me përgjegjësi të kontrollit sistematik për ruajtjen në mënyrë permanente të nivelit higjeno-sanitar, kimik, në të gjithë zonën e Vëndburimit të Naftës në Marinëz, në përputhje me normat ndërkombëtare.

Ruajtjen e nivelit të pastërtisë ekologjike të ajrit, ujrave, tokave dhe bimëve në të gjithë zonën, veçanërisht, kontrolli i ndotjeve të mjedisit nga derdhjet dhe rrjedhjet e naftës, ujrave të ndotura, mbeturinave të naftës ose të gazeve toksike nga pusët e naftës, nga rezervuarët, tubacionet ose autobotet e naftës, nga detonacionet ose shpërthime me pasoja sizmike dhe akustike ndaj zonave të banuara.

1- Ministrisë së Shëndetësisë;

Kryerjen e kontrollit shëndetësor të specializuar falas bashkë me ekzaminimet laboratorike mjekësore të nevojshme, për të gjithë banorët e Marinzës që janë ekspozuar ndaj mjedisit toksik (ajër, ujra, tokë, bimë), si dhe të nevojës për trajtime suplementare të personave me komplikacione eventuale deri në kurimin e tyre.

Kontrrollin sistematik të nivelit toksik të ajrit dhe nëse ai rezulton sot mbi nivelin e lejuar të bëhen propozimet dhe veprimet e nevojshme nga ana e organeve shtetërore për evakuimin nga zona e Marinzës e banorëve të rrezikuar për një periudhë të përkohshme deri në normalizimin e situatës.

Marrjen e masave për moslejimin e konsumit të produkteve bujqësore dhe blegtorale të prodhuara në zonën e ekspozuar nga ndotja me element toksik.

Marrjen e masave të cilat mundësojnë rehabilitimin e sipërfaqes së tokës të intoksikuar.

Marrjen e masave për furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve të zonës së Marinzës, në mënyrë të pandërprerë.

2- Organet e pushtetit lokal në Fier

Marrjen e masave të nevojshme në ndihmë të banorëve të Marinzës, që janë dëmtuar nga shpërthimet e pusit të naftës, për tu kompensuar në përputhje me vlerësimet e miratuara duke bërë edhe çvendosjen e atyre që ju është dëmtuar banesa me rrezik shëmbje si dhe për pasojë të rrëshqitjeve të shtresave të sipërme të tokës pas shpërthimit të pusit

3- Për sejcilën Ministri

Marrjen e nismës për ngritjen e një Komisioni Ekspertësh Shqiptar prej Këshillit të Ministrave, nën kryesinë e një antëtari qeverie, për studimin e nevojës së shpërnguljeve të banorëve të Fshatit Marinëz, Fier.